

URDHËR
Nr. 263, datë 17.4.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E ORAREVE TË LËVIZJES PËR KËMBËSORËT
PENSIONISTË, NËNAT ME FËMIJË , TË SËMURËVE KRONIKË NË TRAJTIM
MJEKËSOR, DHE TË RREGULLAVE PËR LËVIZJEN E MJETEVE PRIVATE**
(Ndryshuar me urdhrin nr. 263/1, datë 18.4.2020, nr. 273, datë 24.4.2020, nr.287, datë 30.4.2020)

I përditësuar

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. *Lejohet lëvizja e këmbësorëve pensionistë, ditën e shtunë dhe ditën e diel, datë 2 dhe 3 maj 2020 deri në orën 10:00, të shoqëruar me jo më shumë se një person në krah.*

1/1. *Lejohet lëvizja e prindërve me fëmijëve deri në moshën 14 vjeç, ditën e shtunë dhe ditën e diel, datë 2 dhe 3 maj 2020, nga ora 11:00 deri në orën 17:30, të pashoqëruar me persona të tjerë në krah*

2. Duke filluar nga dita e hënë, datë 20.4.2020, qytetarët/të sëmurët kronikë, që lëvizin për trajtime mjekësore, të vërtetuar me kopje të dokumentacionit të strukturës shëndetësore dhe që marrin shërbim shëndetësor në spitale (sipas rregullave të përcaktuara për periudhën e epidemisë), apo shoqëruesit e tyre, duhet të vetëdeklarojnë në portalin *e-Albania*, duke përcaktuar orarin e lëvizjes, itinerarin me destinacionin përkatës, si dhe të dhënat e mjetit, në rastet kur lëvizja kryhet me të.

3. Duke filluar nga dita e hënë, datë 20.4.2020, lejohet lëvizja me mjete private, sipas autorizimit përkatës, e të gjithë personave të cilët janë në marrëdhënie pune në një nga veprimtaritë e lejuara, në fashat orare të përcaktuara ose sipas orarit të diktuar nga natyra e punës dhe të paralajmëruara, vetëm për itinerarin shtëpi–punë dhe anasjelltas, pa ndalesa të ndërmjetme.

4. Personat e lejuar të lëvizin me mjete private, sipas pikës 3, të këtij urdhri, lejohen që të marrin vetëm një pasagjer familjar me autorizim pune ose një koleg nga i njëjti vend pune, i cili duhet të ulet në pjesën e pasme të automjetit, i pozicionuar diagonal me drejtuesin e mjetit.

5. Çdo rregull i përcaktuar nga urdhrat e mëparshëm, që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu